

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

Asfaltobeton

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

44113620-7

VLERA E FONDIT LIMIT:

19 328 985(nëntëmbëdhjetë milion e treqind e njëzet e tetë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e pesë lekë) lekë pa tvsh, ose

201 259,74 (dyqind e një mijë e dyqind e pesëdhjetë e nëntë presje shtatëdhjetë e katër) euro.

Sipas kursit zyrtar të Bankës së Shqipërisë (kursi kembimit) Bank of Albania, Exchange rate 1 euro=96.04 exchange rate date 18.03.2026

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,autoriteti kontraktor Ndermarja e Shërbimeve Publike Vlorë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Për përlllogaritjen e fondit limit grupi punës u mbështet në VKM 285 date **19.5.2021** **“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”** neni 76 mënyrat për përlllogaritjen e vlerës së prokurimit

1. Në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti/enti kontraktor duhet t'i referohet një ose më shumë alternativave të renditura, si më poshtë vijon:

a) çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj.); ose/dhe
b) studimit të tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim; ose/dhe

c) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore;

ose/dhe
ç) çmimet ndërkombëtare të shpallura publikisht.

Mënyra e përzgjedhur ishte sipas pikës a pasi në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës. Çmimet janë referuar manualit të cmimeve të miratuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjitikës.

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, **sipas Shtojcës 9;**

b. Sigurimin e Ofertës, sipas **Shtojcës 4;**

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024, 2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se vlera e fondit limit të kontratës që prokurohet**. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43 pika 2/b dhe pika 3 të VKM-se nr. 285 dt. 19.05.2021 të ndryshuar.

Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e xhiros është vendosur që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formes elektronike".

Për këtë procedurë prokurimi Njësia e Prokurimit konsideron të arsyeshme që vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik, nxitjen e konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë si edhe të sigurimin e një trajtimi të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë ofertuesit e mundshëm ekonomikë. Duke patur parasysh, përcaktimin e bërë në nenin 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare” pika 2/a, AK nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së përlllogaritur të vlerës së kontrates në kërkesën për kualifikim, por në respektim të parimeve ligjore dhe në përmbushjen e qëllimeve të ligjit të prokurimit si më sipër cituar ka tagrin të kërkojë një vlerë më të ulët se dyfishi i vlerës së përlllogaritur të kontrates për përmbushjen e vlerës së xhiros minimale vjetore. Kjo vlerë është kërkuar duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar ku përcaktohet se: Autoriteti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare; si dhe nenit 13 të Ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “Për Tatimin Mbi të Ardhurat” i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për deklaratat individuale vjetore e të ardhurave;

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: (2023, 2024, 2025) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, bilancet duhet të shoqërohen edhe me raport auditimi ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese.

Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenit 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare”, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: “Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit”, si dhe në pikën 5 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: Tatimpaguesit që mbajnë kontabilitet sipas kërkesave të ligjit përkatës, paraqesin deklaratën vjetore së bashku me pasqyrat financiare, si dhe të dhëna të tjera të përcaktuara në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat për zbatimin e këtij ligji.”, si dhe kërkesave të ligjit*

Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, për paraqitjen e bilanceve, është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, kërkohen dëshmi për kontrata të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit në një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet, realizuar gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Per kete pikë Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një nga dokumentat e mëposhtme:

- a) Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose fatura tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes të plotësuar sipas legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuar.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim” pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar nenin 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, ku përcaktohet se: “Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.” Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e ngjashme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që kontratat e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe provojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.*

2.3.2. Operatori ekonomik duhet të disponojë fabrikë prodhimi asfalti në pronësi/përdorim/qira ose kontratë furnizimi për mallin objekt prokurimi.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e fabrikës së prodhimit të asfaltit në pronësi/përdorim/qira ose kontratë furnizimi në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Operatori ekonomik i kualifikuar i pari në renditje pas mbylljes së fazës së vlerësimit duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimimit, dokumentacionin provues si më poshtë:

Në rastin e fabrikes në pronësi:

- Dokumentat e pronësisë së fabrikës.
- Leje mjedisore tipi B, kodi III.1.b në përputhje me objektin e prokurimit.

Në rastin e fabrikes në përdorim/qera:

- Kontraten e huapërdorjes/qerasë lidhur para noterit, shoqëruar me dokumentacionin e pronësisë të fabrikës së prodhimit të asfaltit si dhe Lejen mjedisore kodi III.1.b, me afat deri në përfundim të kontratës.

Në rastin e kontratës së furnizimit:

- Kontrate furnizimi lidhur para noterit, shoqëruar me dokumentacionin e pronësisë të fabrikës së prodhimit të asfaltit, me afat deri në përfundim të kontratës.

Fabrika e prodhimit të asfaltobetonit duhet të jetë në një distancë jo më të madhe se 50 km nga adresa e Autoritetit Kontraktor.

Argumentimi: Ky kriter u vendos në përputhje me, nenin 77, pika 4, ligji nr.162, datë 23.12.2021 pasi ben të mundur dhe garanton, përputhshmerine dhe rregullsine e procesit të furnizimit, cilesine e produktit si dhe disponibilitetin të mallit me cilesine e kerkuar, pergjate ekzekutimit të kontrates. Aftësia e operatorëve ekonomikë për të ofruar mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative dhe besueshmërinë për të zbatuar kontratën. nenin 77, pika 4, ligji nr.162, datë 23.12.2021. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës” dhe nenin 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar ku parashikohet se: Për të provuar

përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit“.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion me /huapërdorje/qera ose kontratë furnizimi fabrike për prodhim asfalti i domosdoshëm për të përmbushur kontratën.

Kërkohet kjo fabrikë në përputhje me sasinë e mallit objekt prokurimi, llojit të mallit, konkretisht asfalt, me një volum të përgjithshëm prej 2115 Ton.

Vendosja e kriterit që operatori ekonomik duhet të disponojë një fabrikë prodhimi asfalti në një distancë jo më të madhe se 50 km nga objekti i punimeve është një kërkesë thelbësore që lidhet drejtpërdrejt me cilësinë, qëndrueshmërinë dhe efikasitetin e realizimit të punimeve rrugore.

Asfalti është material termo-sensitiv, i cili duhet të vendoset në një interval të caktuar temperaturash për të garantuar ngjeshjen dhe lidhjen optimale të agregateve me bitumin. Gjatë transportit në distanca të gjata ndodh humbje e konsiderueshme e temperaturës, duke çuar në: vështirësi në shtrimin dhe nivelimin e shtresës, ulje të koeficientit të ngjeshjes, krijim të boshllëqeve dhe mikroçarjeve, reduktim të jetëgjatësisë së rrugës.

Distancat e mëdha rrisin ndjeshëm rrezikun e segregimit të përzierjes asfaltike, ku ndodh ndarja e fraksioneve të agregatit gjatë transportit. Ky fenomen ndikon negativisht në homogjenitetin e shtresës dhe në rezistencën mekanike të saj.

Nga pikëpamja e menaxhimit të punimeve, afërsia e fabrikës mundëson: furnizim të vazhdueshëm dhe të kontrolluar (edhe sipas kërkesës së AK për lëvizim të përditshëm të sasisve të vogla të asfaltit, për asflatimin e gropave në rruget e qytet), reagim të shpejtë ndaj nevojave në terren, kontroll më të mirë të cilësisë së materialit në kohë reale.

Gjithashtu, standardet teknike rekomandojnë që koha e transportit të përzierjes asfaltike të jetë sa më e shkurtër, zakonisht brenda 1–2 orëve, çka në kushte normale korrespondon me një distancë maksimale rreth 50 km.

Përcaktimi i kufirit maksimal prej 50 km nuk është kufizues në mënyrë të padrejtë për operatorët ekonomikë, por një domosdoshmëri teknike që garanton cilësinë e punimeve, jetëgjatësinë e investimit dhe përdorimin eficient të fondeve publike.

2.3.3 Operatorët ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet e mëposhtme:

Nr.	Mjetet	Sasia	Gjendja
1	Kamion vetshkarkues me kapacitet min 20 ton	3 copë	pronësi/përdorim/qira

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e mjeteve të sipërpërmendura në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Operatori ekonomik i kualifikuar i pari në renditje pas mbylljes së fazës së vlerësimit duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, dokumentacionin provues si më poshtë;

a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet:

1. Leje qarkullimi (e vlefshme)
2. Certifikatën e kontrollit teknik (e vlefshme)
3. Policë sigurimi (e vlefshme)
4. Mjeti të shoqërohet me fotografi të dukshme

Për mjetet me përdorim/qira

1. Për mjetet e marra me përdorim/qira të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e huapërdorjes/qirasë (me vlefshmeri sa kohëzgjatja e MK).
2. Leje qarkullimi (e vlefshme)
3. Certifikatën e kontrollit teknik (e vlefshme)
4. Policë sigurimi (e vlefshme)
5. Mjeti të shoqërohet me fotografi të dukshme.

Argumentimi: Në bazë të nenit 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), si dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), është përcaktuar ky kriter, me anë të të cilit kërkohet që operatorët ekonomikë të garantojnë Autoritetin Kontraktor se disponojnë mjetet e nevojshme të transportit dhe se do të kryejnë shpërndarjen e mallrave objekt prokurimi në adresat e përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor përfitues. Vendosja e këtij kriteri synon të sigurojë që operatori ekonomik të garantojë shërbimin e transportit në kohë dhe në përputhje me afatet e kontratës..

Kërkesa për të pasur në dispozicion minimumi tre mjete transporti është përcaktuar në mënyrë proporcionale me sasinë e mallrave të kërkuar dhe me vendndodhjen e Autoritetit Kontraktor, ku ky mall do të përdoret. Ky kusht garanton sigurinë, vijueshmërinë dhe cilësinë e shërbimit të transportit, duke ulur rrezikun e vonësve ose ndërprerjeve në procesin e furnizimit.

2.3.4 Operatorët ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës objekt prokurimi, duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht 3 (tre) punëtorësh.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Operatori ekonomik i kualifikuar i pari në renditje pas mbylljes së fazes së vlerësimit duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimimit, dokumentacionin provues si më poshtë:

- Listpagesën e muajit të fundit sipas formularit standart për sigurimet;
- Vërtetim nga administrata tatimore për numrin e punonjësve të siguruar.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar ku parashikohet se ”4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës” dhe nenin 40, pika 5/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar ku parashikohet se: Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit“. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

2.3.5 Operatorët Ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar 3 (tre) drejtues mjetesh për mjetet e kerkuara.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e punojësve të sipërpërmendur në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Operatori ekonomik i kualifikuar i pari në renditje pas mbylljes së fazës së vlerësimit duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimimit, të gjithë dokumentacionin provues si më poshtë:

- kontratë pune të vlefshme;
- dëshminë e drejtimit të automjetit të vlefshme;

Argumentimi: Ky kriter është vendosur bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar ku parashikohet se ”4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose

entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës” dhe nenin 40, pika 5/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar ku parashikohet se „5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit“.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës, për dorëzimin e mallit në kohë dhe pa vonesa.

2.3.6 Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë fletë analize ose raport testimi të lëshuar nga organe kompetente shtetërore ose private të akredituara, për mallin objekt prokurimi.

Argumentimi: Ky kriter bazohet në nenin 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 40, pika 6/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku citohet: dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike. Në rastin konkret, kemi të bëjmë me një kërkesë minimale, për një dokument cilësie për materialet që autoriteti kontraktor, kërkon të blejë.

Përsa me sipër kërkohet një dokument certifikues i cilësise, pra në përputhje me nenin 77, ligji nr.162, datë 23.12.2021. dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike të kërkuara, që kanë lidhje dhe janë proporcionale me objektin e kontratës, sipas preventivit, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit, pasi janë lehtësisht të siguroshme, me kosto të ulët, si dhe plotësueshme nga cdo operator që është në gjendje dhe do të realizojë një furnizim si ai që kërkon objekti të kontratës.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të paraqesë çertifikatë cilësie (të vlefshme) ISO 9001:2015 (Sistemi i menaxhimit të Cilësisë) ose ekuivalente, për prodhuesin e asfaltobetonit të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizma kombëtar të akreditimit i vendit ku është akredituar ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Shqipëri (DPA), e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 1 të nenit 79 të Ligjit nr. 162/2020, “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se autoriteti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet objekt prokurimi plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve paraqitjen e certifikatave të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues, të

njohur nga Republika e Shqipërisë. E njëjta dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike lidhen me kualifikimet e kandidatit apo ofertuesit. Gjithashtu, ky kriter mbështetet në pikën 1 të nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë ofertuesve paraqitjen e certifikatave të tilla vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit. Ky kriter është vendosur për të garantuar njohjen e kapacitetit të operatorëve ekonomikë dhe për të vlerësuar aftësinë e tyre teknike dhe profesionale në drejtim të furnizimit me artikuj cilësorë, të prodhuar ose të hedhur në treg sipas standardeve ndërkombëtare. Certifikata e kërkuar ka lidhje dhe është proporcionale me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit

2.3.8 Operatori Ekonomik duhet të dorëzojë një deklaratë nëpërmjet së cilës merr përsipër furnizimin e AK me mallin objekt prokurimi në të gjithë ditët e javës, në destinacionin e kërkuar nga AK.

Argumentimi: Në bazë të nenit 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), si dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), është përcaktuar ky kriter, me anë të të cilit kërkohet që operatorët ekonomikë të garantojnë Autoritetin Kontraktor se marrin përsipër furnizimin e AK në të gjitha ditët e javës dhe të kryejnë shpërndarjen e mallrave objekt prokurimi në adresat e përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor. Dorëzimi i kësaj deklaratë nga operatorët pjesëmarrës ka të bëjë me aktivitetet që lidhen me përdorimin e asfaltit të cilat karakterizohen nga nevoja të vazhdueshme, ku kërkesat lindin në mënyrë dinamike, shpesh të paparashikueshme dhe në volume të kufizuara ditore. Kjo lidhet me ndërhyrje emergjente në terren, mirëmbajtje të përditshme dhe punime të shpërndara në zona të ndryshme.

Në këto kushte, furnizimi në sasi të mëdha dhe me intervale të rralla nuk është praktik dhe nuk i përgjigjet nevojave reale të Autoritetit Kontraktor.

Furnizimi ditor me sasi të vogla siguron fleksibilitet operacional, duke mundësuar reagim të menjëhershëm ndaj situatave në terren,

Kjo kërkesë garanton që operatori ekonomik të ketë kapacitet logjistik të mjaftueshëm (mjete transporti funksionale dhe të disponueshme),

organizim të brendshëm të përshtatshëm për shpërndarje të shpejtë dhe të vazhdueshme, burime njerëzore dhe planifikim që mbështet furnizimin në baza ditore.

Deklarata i shërben AK si një instrument sigurie që minimizon rrezikun e ndërprerjes së furnizimit, rrit përgjegjshmërinë e operatorit ekonomik, krijon bazë për monitorim dhe zbatim korrekt të kontratës.

Në mungesë të këtij angazhimi, ekziston rreziku që operatorët të favorizojnë furnizime të rralla dhe me volum të madh, duke krijuar vonesa në realizimin e punimeve, mungesë materiali në momente kritike, ulje të eficiencës në përdorimin e burimeve publike.

Kërkesa për paraqitjen e një deklarate për furnizim ditor me sasi të vogla nuk është kufizuese, por një domosdoshmëri teknike dhe organizative, e lidhur drejtpërdrejt me natyrën e shërbimit, garantimin e vazhdimësisë së punimeve dhe përdorimin eficient të fondeve publike.

SPECIFIKIME TEKNIKE

Objekti i këtij furnizimi konsiston në prodhimin, furnizimin dhe transportin e përzierjes asfaltike (asfaltobeton) që do të përdoret për mbushjen e gropave dhe riparimin e dëmtimeve lokale në rrjetin rrugor në administrim të autoritetit kontraktor.

Sasia e parashikuar për furnizim është rreth 2115(dy mijë e njëqind e pesëmbëdhjetë) ton asfaltobeton ose 9613 (nëntë mijë e gjashtëqind e trembëdhjetë) m³, në përputhje me fondin limit të përlllogaritur për këtë procedurë. Furnizimi do të realizohet sipas nevojave të autoritetit kontraktor gjatë periudhës së zbatimit të kontratës.

Asfaltobetoni duhet të prodhohet në impiant të licencuar për prodhimin e përzierjeve asfaltike, në përputhje me standardet teknike shqiptare për materialet dhe shtresat asfaltike. Përzierja asfaltike duhet të jetë homogjene dhe pa segregim, me mbulim të plotë të aggregateve me material lidhës bituminoz dhe pa praninë e kokrrizave të pambuluara me bitum.

Materialet gurore që përdoren për prodhimin e asfaltobetonit duhet të jenë materiale të thyer me cilësi të mirë mekanike, të pastra nga papastërtitë dhe materialet argjilore, me përmasa granulometrike nga 5 mm deri në 10 mm. Materiali guror duhet të ketë rezistencë në shtypje në intervalin 700–900 kg/cm², ndërsa koeficienti i konsumit nga prova Los Angeles (LA) duhet të jetë më i vogël se 15%, duke garantuar rezistencën e shtresës asfaltike ndaj trafikut dhe kushteve atmosferike.

Përzierja asfaltike duhet të përgatitet nga aggregate minerale dhe material lidhës bituminoz në përpjesëtime të përshtatshme, ku përbërja orientuese e aggregateve duhet të jetë rreth 40% çakëll dhe 60% rërë, në mënyrë që të sigurohet shpërndarje e rregullt granulometrike dhe stabilitet i përzierjes asfaltike.

Bitumi që përdoret për prodhimin e asfaltobetonit duhet të jetë bitum rrugor me penetrim të përshtatshëm për kushtet klimatike dhe të trafikut, zakonisht i tipit 50–70 ose 60–80, dhe duhet të përmbushë kërkesat e standardeve shqiptare STASH 660-87 dhe STASH 21-60. Në periudhat me temperatura të larta (sezoni veror) rekomandohet përdorimi i bitumit me penetrim 80–120 ose me pikë zbutjeje më të lartë për të garantuar qëndrueshmëri më të mirë të materialit asfaltik.

Përmbajtja e bitumit në përzierjen asfaltike duhet të jetë jo më pak se 4.5%, ndërsa densiteti mesatar i përzierjes duhet të jetë rreth 2.2 g/cm³.

Temperatura e përzierjes së asfaltobetonit në momentin e prodhimit dhe të furnizimit duhet të jetë rreth 150°C, në mënyrë që materiali të jetë i përshtatshëm për përdorim të menjëhershëm në punimet e mirëmbajtjes së rrugëve dhe mbushjen e gropave.

Granulometria e përzierjes asfaltike duhet të jetë në përputhje me kufijtë e mëposhtëm:

Dimensioni i sitës (mm) Kalimi në sitë (%)

0.075	5 – 10
0.18	90 – 95
0.4	85 – 93
2	62 – 75
5	40 – 55
10	45 – 60
15	10 – 30

Lejohet një devijim i përbërjes granulometrike brenda kufijve $\pm 2\%$.

Karakteristikat fiziko–mekanike të përzierjes asfaltike duhet të plotësojnë parametrat e mëposhtëm:

Parametri	Vlera e kërkuar
Përmbajtja e bitumit	4.5 – 6 %
Stabiliteti Marshall (75 goditje)	≥ 1000 kg
Rigjiditeti Marshall	> 300 kg/mm ²
Boshlleqet Marshall	3 – 6 %

Densiteti në vepër (krahasuar me densitetin Marshall) ≥ 97 %

Operatori ekonomik duhet të garantojë cilësinë e materialit asfaltik dhe, me kërkesë të autoritetit kontraktor, të paraqesë **analiza laboratorike për përzierjen asfaltike (Job Mix Formula)**, si dhe rezultatet e provave për granulometrinë, përmbajtjen e bitumit dhe karakteristikat mekanike të materialit.

Transporti i asfaltobetonit duhet të kryhet me mjete të përshtatshme transporti, të pajisura në mënyrë që të ruhet temperatura dhe cilësia e përzierjes asfaltike deri në momentin e dorëzimit.

Matja e furnizimit do të realizohet në **ton**, mbi bazën e sasisë së materialit të dorëzuar dhe të pranuar nga përfaqësuesit e autoritetit kontraktor. Çmimi i ofertuar duhet të përfshijë prodhimin e

përzierjes asfaltike, furnizimin me materialet përbërëse, transportin dhe çdo shpenzim tjetër të nevojshëm për realizimin e plotë të furnizimit.

Argumentimi i specifikimeve teknike: Specifikimet teknike janë hartuar nga komisioni i ngritur në përbërje të së cilit është specialisiti i fushës, anëtar i Njësisë së Prokurimit.

Specifikimet teknike, për procedurën objekt prokurimi, shprehin qartë kërkesat e autoritetit kontraktor për cilësinë e mallit dhe lidhen ngushtë me natyrën e kontratës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, **duke argumentuar çdo specifikim dhe standard të kërkuar.**

*Specifikimet teknike të përcaktuara për furnizimin me asfaltobeton janë hartuar në përputhje me kërkesat funksionale të mirëmbajtjes rrugore dhe synojnë garantimin e një materiali me performancë të lartë, jetëgjatësi dhe rezistencë ndaj kushteve të trafikut dhe faktorëve atmosferikë. **Së pari**, kërkesa që asfaltobetonin të prodhohet në impiante të licencuara dhe sipas standardeve teknike siguron që përzierja asfaltike të jetë e kontrolluar në mënyrë industriale, duke garantuar homogjenitet, dozimin korrekt të përbërësve dhe eliminimin e defekteve si segregimi apo mbivendosja jo e plotë e agregateve me bitum. Kjo është thelbësore për cilësinë dhe qëndrueshmërinë e shtresës së vendosur në rrugë.*

***Së dyti**, përcaktimi i karakteristikave të agregateve (rezistenca në shtypje, koeficienti Los Angeles $\leq 15\%$, pastërtia dhe granulometria 5–10 mm) është i domosdoshëm për të garantuar rezistencë të lartë ndaj konsumit dhe fërkimit nga trafiku, qëndrueshmëri strukturore të shtresës asfaltike, shmangien e degradimit të parakohshëm si plasaritje apo shpërbërje.*

***Së treti**, përbërja granulometrike e kontrolluar përmes sitave dhe lejimi i devijimit maksimal $\pm 2\%$ siguron një shpërndarje optimale të grimcave, duke ndikuar drejtpërdrejt në rritjen e densitetit dhe kompaktimit, uljen e boshllëqeve ajrore, përmirësimin e lidhjes ndërmjet agregatit dhe bitumit. Këto elemente janë thelbësore për të shmangur depërtimin e ujit dhe dëmtimet nga ngrirje-shkrirja.*

***Së katërti**, parametrat e përcaktuar sipas metodës Marshall (stabilitet ≥ 1000 kg, rigiditet ≥ 300 kg/mm², boshllëqe 3–6%, densitet $\geq 97\%$) janë tregues standardë ndërkombëtarë për vlerësimin e performancës së përzierjes asfaltike. Këta parametra garantojnë: rezistencë të mjaftueshme ndaj deformimeve plastike (rrëshqitje, valëzim), elasticitet të kontrolluar për të përballuar ngarkesat dinamike, strukturë kompakte dhe jetëgjatësi të shtresës.*

***Së pesti**, kufijtë e përcaktuar për përmbajtjen e bitumit (4.5–6%) janë të domosdoshëm për të arritur balancën optimale midis: lidhjes së agregateve (kohezionit), rezistencës ndaj deformimit, shmangies së fenomenit të rrjedhjes së bitumit në temperatura të larta.*

***Së gjashti**, kërkesa për temperaturën e prodhimit dhe furnizimit ($\sim 150^\circ\text{C}$) është kritike për ruajtjen e punueshmërisë së materialit dhe për të siguruar vendosjen dhe kompaktimin korrekt në terren, veçanërisht në ndërhyrje të shpejta për mbushje gropash.*

***Së shtati**, detyrimi për paraqitjen e analizave laboratorike (Job Mix Formula) dhe kontrollin e vazhdueshëm të cilësisë garanton që materiali i furnizuar përputhet me parametrat e kërkuar dhe krijon bazë për verifikim objektiv gjatë zbatimit të kontratës.*

Kërkesat për transportin me mjete të përshtatshme që ruajnë temperaturën dhe cilësinë e përzierjes janë thelbësore për të shmangur humbjen e vetive teknike të asfaltobetonit deri në momentin e aplikimit.

Specifikimet e përcaktuara nuk janë kufizuese, por përbëjnë një paketë të domosdoshme kriteresh teknike, të cilat garantojnë cilësinë, qëndrueshmërinë dhe performancën afatgjatë të ndërhyrjeve për mbushjen e gropave në rrugë, duke siguruar njëkohësisht përdorim eficient të fondeve publike dhe minimizim të kostove të mirëmbajtjes në të ardhmen.

NJËSIA E PROKURIMIT